

“LEXIMI” EFEKTIV I ASETETEVE TË TRASHËGIMISË SI ELEMENT JETIK PËR TRANSMETIMIN KULTUROR

VASILIKA RRAKU

Filiali Sarandë

Universiteti i Tiranës

rraku.vasilika@gmail.com

ABSTRACT

The aim of this article is to point out the importance of correct interpretation of cultural heritage data as the cornerstone of cultural heritage transmission, focusing on three main stages of vital importance to this process: Perception, interpretation and communication. Perception is considered to be the first stage of acquiring information from heritage assets through the use of all senses. Interpretation is the stage of assigning meaning to observed stimuli based on previously acquired knowledge of the field. The aptitude of correct interpretation lies on several closely related factors, such as the person's general knowledge of the area of study, observation skills, the ability to “read” through the images and symbols making use of the imagination, construction of meaning, etc. The last stage in the process of cultural transmission is communication, which can be performed in two forms, verbal and non-verbal. The article continues with an explanation of the principal communication techniques for successful transmission of the cultural heritage, giving special emphasis to the importance of body language in interpersonal and small-group communication and the importance of using virtual technologies in public and mass communication. Finally, the article concludes with several suggestions on the ways of transmitting cultural heritage effectively through proper perception, interpretation and communication of heritage assets.

Keywords: Heritage assets, perception, interpretation, communication, transmission, stages

Trashëgimia kulturore është një element i padiskutueshëm i identitetit kombëtar. Ajo të jep mundësinë të kuptosh traditat specifike të paraardhësve, duke i parë ato në këndvështrimin historik për të arritur tek të kuptuarit e asaj që ne jemi. Në dekada, që nga miratimi i Konventës së Trashëgimisë Botërore, ‘krizat’ e ndryshme të përkufizimit kanë ndikuar ndjeshëm në mënyrat në të cilat trashëgimia klasifikohet, perceptohet dhe menaxhohet në shoqëritë bashkëkohore globale.¹ Trashëgimia mund të ndahet në dy kategori kryesore. Nga njëra anë, ekziston një trashëgimi që paraqitet në një formë materiale, të prekshme: arkeologji, art, objekte të luajtmshme, arkitekturë dhe peizazh.

Nga ana tjetër, ekziston një formë tjetër e trashëgimisë, e cila quhet “trashëgimia kulturore jomateriale”². Ky emërtim u konceptua në mënyrë që të njiheshin dhe të merreshin në konsideratë disa realitete, të cilat mbetën të padukshme për një periudhë të gjatë kohore dhe që nuk përshtateshin si pjesë e ndonjë kategorie tjetër të krijuar të trashëgimisë. Ajo përfshin traditat ose shprehjet e gjalla të trashëguara nga paraardhësit tanë dhe të përcjella te pasardhësit tanë, si gojëdhënat, artet e skenës, ritualet, ngjarjet festive, njohuritë dhe praktikat në lidhje me natyrën dhe universin ose njohuritë dhe aftësitë për të prodhuar zanate tradicionale.

Trashëgimia kulturore jomateriale është një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e diversitetit kulturor përballë globalizimit në rritje. Kuptimi i trashëgimisë kulturore jomateriale të komuniteteve të ndryshme ndihmon në dialogun ndërkulturor dhe inkurajon respektin e ndërsjelltë për mënyra të tjera të jetesës. Rëndësia e trashëgimisë kulturore jomateriale nuk është vetë manifestimi kulturor, por pasuria e njohurive dhe aftësive që transmetohet nëpërmjet saj nga një brez në tjetrin.

Vlera sociale dhe ekonomike e këtij transmetimi të njohurive është e rëndësishme si për grupet minoritare dhe për grupet kryesore shoqërore brenda një shteti, dhe është gjithashtu po aq e rëndësishme për shtetet në zhvillim sa edhe për ato të zhvilluara. Trashëgimia kulturore duhet të prezantohet në botë, sepse ajo afirmon identitetin tonë si popull dhe krijon një kornizë gjithëpërfshirëse për ruajtjen e saj.

¹ Anders Högberg (2016), Rodney Harrison: Heritage. Critical Approaches, Routledge, Londër.

I. Perceptimi, interpretimi dhe komunikimi i trashëgimisë kulturore

Trashëgimia është një koncept i vështirë për t'u përcaktuar, sepse mund të mbulojë një grup të madh objektsh dhe idesh në dukje të ndryshme. Këto variojnë nga një lidhje e fortë me tokën përmes stileve specifike të artit dhe manifestimeve të dallueshmërisë kulturore deri tek produktet komerciale për prodhimin e të cilave janë përdorur proceset tradicionale të prodhimit të tyre. Në një nivel të përgjithshëm, trashëgimia është diçka që individët në mënyrë emocionale pretendojnë se e kanë të tyren ose e shohin si të dikujt tjetër, por gjithmonë si diçka që përcillet nga brezat e mëparshëm. Perceptimi i trashëgimisë kulturore kushtëzohet si nga gjendja e vëzhguesit ashtu edhe nga artisti. Stilet e artit zhvillohen nga një vendim i vullnetshëm i një artisti që e hedh frymëzimin e tij në formë vizuale brenda trajektoreve historike dhe vjen si një deformim koherent në traditat e trashëguara.

Në art, kuptimet e marra nga perceptimi përqendrohen në shprehjen vizuale dhe stili përfaqëson “një interpretim, një mënyrë fakultative të përshkrimit të botës.”³ Për realizimin e perceptimit të saktë të formave të ndryshme të trashëgimisë kulturore vijnë në ndihmë skemat kulturore. Skemat kulturore janë pasqyrime orientuese të përbashkëta shoqërore që aktivizohen në njohjen automatike. DiMaggio i përkufizon skemat si “struktura njohurish që pasqyrojnë objekte ose ngjarje dhe ofrojnë supozime të paracaktuara rreth karakteristikave të tyre, lidhjeve dhe konkluzioneve në kushtet e informacionit jo të plotë” (DiMaggio 1997) ⁴.

Konceptualizimi i “supozimeve të paracaktuara” është një përshkrim i qartë dhe i matur i skemave si mjete të kompletimit të modeleve që plotësojnë pjesët e munguara të njohurive me paracaktimet e mësuara kulturore. Kështu, skemat përkatëse plotësojnë informacionin që mungon duke na lejuar të perceptojmë copëzat e shkëputura si pjesë e një tërësie kuptimplotë. Ndërsa qëllimi i skemave

³ Merleau-Ponty M., (2012), *Phenomenology of Perception*, Routledge, UK

⁴ DiMaggio, P. (1997), *Culture and Cognition*, në “*Annual Review of Sociology*”, Volumi 23, fq. 263–287.

stereotype është plotësimi i informacionit që mungon, funksioni i parë i skemave kategorizuese është moskonsiderimi i informacionit që është i pavend. Kategorizimi i objekteve thjeshton botën e perceptuar sepse lejon që objekte të ndryshme të trajtohen si ekuivalente (Goldstone, Kersten dhe Carvalho 2018)⁵.

Ky proces funksionon kryesisht duke lidhur në mënyrë holistike stimulim me paraqitjet njohëse të prototipeve. Aktivizimi i një kategorie të nënkuptuar mund të rezultojë përfundimisht në aktivizimin e një stereotipi. Skemat kulturore mund të ndikojnë mbisjelljen në të paktën dy mënyra relativisht të drejtpërdrejta: (i) si kategori të nënkuptuara, stereotype dhe grupe të tjera të “supozimeve të paracaktuara” automatike, të cilat ndikojnë mbi atë që njerëzit perceptojnë, mbajnë mend ose kuptojnë lidhur me çfarë thonë të tjerët dhe (ii) si norma të brendshme, intuited morale dhe receta kulturore të zakonshme, që shkaktojnë veprime të drejtpërdrejta nëpërmjet proceseve njohëse të ngjashme me refleksin, të cilat ndodhin pa vetëdijen dhe kontrollin e ndërgjegjshëm të individëve. (DiMaggio 1997) Interpretimi, si faza e dytë e transmetimit të trashëgimisë kulturore, i referohet gamës së plotë të aktiviteteve të mundshme që synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të kuptuarin e publikut në lidhje me burimet e trashëgimisë kulturore⁶. Interpretimi dhe prezantimi efektiv duhet të përmirësojë përvojën personale, të rrisë respektin dhe mirëkuptimin e publikut, si dhe të komunikojë rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Individët dhe komunitetet inkurajohen të reflektojnë vetë perceptimet e një monamenti të trashëgimisë kulturore dhe ndihmohen në krijimin e lidhjeve kuptimplote me të, me qëllimin për të nxitur më tej interesin, mësimin, përvojën dhe eksplorimin.

Interpretimi duhet të shfaqë gamën e informacioneve verbale dhe të shkruara, gjetjeve materiale, traditave dhe kuptimeve që i atribuohen një burimi të trashëgimisë kulturore. Interpretimi duhet të mbështetet në një hulumtim shumëdisiplinar të mirëstudjuar të monumentit kulturor dhe rrethinave të tij. Gjithashtu duhet të pranojmë se interpretimi kuptimplotë përfshin domosdoshmërisht reflektimin mbi

⁵ Robert L. Goldstone, Alan Kersten, Paulo F. Carvalho (2018), Concepts and Categorization, në “Handbook of Psychology”, botimi i dytë

⁶ ICOMOS (2008), Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites, Québec

hipotezat historike alternative, traditat vendore dhe tregimet.

Në vendet e trashëgimisë kulturore ku tregimet tradicionale ose kujtimet e pjesëmarrësve historikë ofrojnë një burim të rëndësishëm informacioni rreth rëndësisë së vendit, programet interpretuese duhet t'i përfshijë këto dëshmi gojëdhënore, qoftë në mënyrë indirekte, nëpërmjet infrastrukturës, ose drejtpërdrejt, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të komuniteteve të lidhura me to. Rindërtimi vizual, qoftë nga artistët, arkitektët, apo modeluesit kompjuterikë, duhet të mbështetet në analizën e detajuar dhe sistematike të të dhënave mjedisore, arkeologjike, arkitekturore dhe historike, përfshirë analizën e burimeve të shkruara, gojëdhënore, ikonografike dhe fotografike.⁷

Komunikimi, si faza e tretë e transmetimit të trashëgimisë kulturore, luan një rol të rëndësishëm jo vetëm për promovimin e trashëgimisë kulturore, por edhe për stimulimin e zhvillimit të turizmit. Komunikimi për turizmin e qëndrueshëm lokal do të përfshijë përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi një gamë të gjerë pasurish vendore, natyrore, peizazhesh kulturore, traditash të trashëgimisë, zanatesh dhe aftësish, ngjarjesh kulturore, si dhe mbi artin dhe kulturën bashkëkohore.⁸

Disa nga përparësitë e komunikimit të qartë të vlerave të trashëgimisë janë:

- Operatorët turistikë mund të zhvillojnë produkte unike dhe më të sofistikuar, si dhe të ofrojnë përvoja që u përshtaten më mirë interesave të vizitorëve, duke krijuar diferencim të produktit dhe rezultate konkurruese.
- Menaxherët e trashëgimisë dhe operatorët turistikë mund të nxisin mbështetjen për ruajtjen e trashëgimisë, duke u siguruar që vlerat e rëndësishme të një vendi të mos ndikohen negativisht nga aktivitetet apo produktet turistike.
- Vizitorët bëhen shumë më të vetëdijshëm për çështjet mjedisore dhe dallimet ndërmjet kombeve dhe kulturave.

Komunikimi i trashëgimisë mund të ushtrojë gjithashtu një ndikim të fuqishëm në mënyrën se si e sheh atë komuniteti pritës dhe në

⁷ ICOMOS (2008), Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites, Québec.

⁸ UNWTO (2011), Communicating Heritage – A Handbook for the Tourism Sector, World Tourism Organization, Madrid, Spanjë.

reagimin e tij ndaj aktivitetit turistik lokal. Ai mund të rrisë vlerësimin e komunitetit për burimet e ndryshme lokale që mund të mbështeten nga shpenzimet turistike, të tilla si atraksionet natyrore ose kulturore.

Përveç formës verbale, ku studimi i gjuhës mund të përdoret për të kuptuar sjelljen dhe përvojën njerëzore,⁹ komunikimi kulturor mund të realizohet edhe në formën joverbale, përmes gjesteve dhe gjuhës së trupit. Përdorimi i gjuhës gjestike merr rëndësi dhe ka vlerë më të madhe në mjedisin global multikulturor, me dallime demografike dhe kulturore si gjuha, rajoni, gjinia, mosha, feja, etj.

Gjuha gjestike zhvillon marrëdhëniet multikulturore, kompetencën, mirëkuptimin dhe harmoninë sociale dhe heq pengesat dhe konfliktet multikulturore. Ajo mundëson jo vetëm ndërthurjen e njerëzve me kulturat e ndryshme, por edhe shpalosjen e kapitalit kulturor dhe social e njerëzor. Kështu, përdorimi i gjuhës gjestike luan një rol të rëndësishëm për të siguruar një komunikim efektiv multikulturor.¹⁰

Komunikimi i aseteve të trashëgimisë kulturore përmes rristurimit të tyre duhet të kontribuojnë në ruajtjen e autenticitetit duke komunikuar rëndësinë e tyre, pa ndikuar negativisht në vlerat kulturore që mbartin apo ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme strukturën e tyre. Të gjitha infrastrukturat e dukshme interpretuese duhet të jenë të ndjeshme ndaj karakterit, mjedisit dhe rëndësisë kulturore dhe natyrore të vendit.¹¹ Aq më tepër tashmë, që mënyrat e komunikimit kanë ndryshuar dhe dixhitalizimi i njohurive dhe informacionit thjeshton marrjen e informacionit më të përpunuar dhe demokratizon disponueshmërinë e njohurive specifike të orientuara ndaj subjektit (Borgmann 2010)¹². Për më tepër, mundësitë e ndryshme që rezultojnë nga teknologjitë dixhitale kanë ndikim të madh në paraqitjen e informacionit dhe perceptimin e tij.

Trashëgimia kulturore tashmë i nënshtrohet një larmie të madhe detyrash komunikimi të kryera në një mori mënyrash nga shumë

⁹ Vivien B. (2015), Social Constructionism, botimi i tretë, Routledge, Londër.

¹⁰ Jaya N. (2011), Importance of Body Language in Effective Multicultural Communication, në <https://typeset.io/pdf/importance-of-body-language-in-effective-multicultural-572wnkfjym.pdf>

¹¹ ICOMOS (2008), Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites, Québec

¹² Albert B. (2010), Reality and Technology, në “Cambridge Journal of Economics”, Volumi 34, Faqja 27-35.

metodologji të ndryshme. Trashëgimia dhe vlerat e saj komunikohen përmes turneve në qytet, ekspozitave, faqeve të internetit, fletëpalosjeve, librave, aplikacioneve për smartphone, faqeve të internetit, lojërave, mësimëve të artit në shkollë dhe shumë aktiviteteve dhe rrugëve të tjera.¹³

Kështu, lind sfida e trajtimit të mospërputhjes së brendshme të dy identiteteve antagoniste (individualitetit/veçantisë dhe pritsshmërive sociale/ përshtatjes) në një mënyrë graduale përshtatjeje për të fituar një identitet të ekuilibruar.¹⁴ Në këtë aspekt, teknologjitë virtuale të komunikimit të trashëgimisë kulturore po zënë gjithnjë e më tepër një vend të rëndësishëm për transmetimin e trashëgimisë kulturore. Të virtualizosh trashëgiminë do të thotë të aktualizosh përmbajtjen e trashëgimisë në mënyrë dixhitale dhe ta simulosh atë duke përdorur teknologjinë grafike kompjuterike. Karakteristikat e “trashëgimisë virtuale” përfshijnë lehtësimin e sintezës, ruajtjes, riprodhimit, përfaqësimit, ripërpunimit dixhital dhe shfaqjes së trashëgimisë kulturore duke përdorur përparimet e teknologjisë së realitetit virtual.¹⁵

Për shkak të pajisjeve kompjuterike të avancuara dhe kartave grafike të nivelit të lartë, tendencat aktuale në aplikacionet e realitetit virtual janë të prirura drejt përdorimit të teknologjisë gjithëpërfshirëse për ndërveprim në kohë reale me detaje të imta.

Disa nga avantazhet që Realiteti Virtual i jep trashëgimisë kulturore përfshijnë:

- Dokumentimin, regjistrimin dhe ruajtjen e trashëgimisë ndër-kombëtare në të gjithë botën.
- Rimëkëmbjen virtuale të trashëgimisë së humbur.
- Asistimin në procesin e arsimit për studentët, veçanërisht ata të arkitekturës dhe transferimin e tyre virtualisht në një botë tjetër, çka i bën ata të ndihen sikur janë duke ecur në të kaluarën.
- Zhvillimin e një biblioteke të pasur për arkitektët, për t'i ndihmuar ata në restaurimin e vendeve historike.

¹³ Matthias R., Susanne H. (2017): Communication Model for Built Heritage Assets Going from Knowing to Identification (2017), World Heritage Coordination, Regensburg, Germany.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ R. M. Reffat, E. M. Nofal (2013), Effective communication with cultural heritage using virtual technologies, në “International Archives of the Photogrammetry, Remote Sensing and Spatial Information Sciences”, Volume XL5/W2.

- Përhapjen e kulturës, trashëgimisë dhe traditës vendase të cilat kontribuojnë në tërheqjen e turistëve në vend. (El-Razaz, 2007)¹⁶

Aktualisht, kombinimi i trashëgimisë kulturore dhe realitetit virtual është bërë një prire kryesore. Ai jo vetëm që mund të zgjidhë kontradiktën që ekziston për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por ka edhe avantazhe të pakrahasueshme në përhapjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Në sfondin e përshpejtimit të globalizimit dhe modernizimit ekonomik, mbrojtja e trashëgimisë kulturore përballët me shumë sfida. Elementet e trashëgimisë kulturore preken lehtësisht nga forca natyrore dhe njerëzore. Investimet për mbrojtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore janë të kufizuara. Kombinimi i teknologjisë së Realitetit Virtual dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore mund të çojë në shfaqjen e trashëgimisë kulturore me precizion të lartë, në shkallë të gjerë, interaktive dhe me audiencë të gjerë, të tillë si ruajtja dixhitale, restaurimi virtual, shfaqja e publicitetit, shfletimi virtual, muzeu dixhital e kështu me radhë, në mënyrë që të realizohet zgjidhja e problemeve tradicionale në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Kjo është e favorshme jo vetëm për mbrojtjen e relikteve kulturore dhe vendeve historike, por edhe për të rritur mundësitë e prezantimit të trashëgimisë kulturore dhe vlerën ekonomike dhe kulturore të saj.¹⁷ Realiteti virtual shpesh përkufizohet në termat e harduerit teknologjik që krijon dimensione të përvojës, duke ofruar nivele të ndryshme gjallërie dhe ndërveprimi në një mjedis gjithëpërfshirës ose pothuajse realist, duke sjellë iluzionin tek shikuesi të zhytjes në ndërveprimin njeri-kompjuter. Teknologjia e realitetit virtual vepron në sistemin e perceptimit të njeriut nëpërmjet kompjuterit dhe teknologjive të komunikimit, duke i lejuar njerëzit të hyjnë plotësisht dhe të ndërveprojnë me botën virtuale. Kjo i lejon njerëzit të kenë iluzionin e tejkalimit të kufizimeve të kohës dhe hapësirës dhe kufizimeve materiale.

¹⁶ Bayt al-Razzaz (2007), The challenge of adaptive use for a vacant mamluk palace in Cairo, në “International Journal of Heritage Studies”, Volumi 3.

¹⁷ Pei J. & Yi L. (2022): Fluid space: Digitalization of cultural heritage and its media dissemination, në “Telematics and Informatics Reports”, Volumi 8.

Modelet e hershme të realitetit virtual mbështeteshin shumë në syrin dhe dorën e njeriut për të krijuar një ndjenjë pranë në hapësirën virtuale. Me shfaqjen e mediave dixhitale, komunikimi interaktiv është rritur në bazë të komunikimit të përqëndruar. Kjo mënyrë transmetimi nuk është njëkahëshe, por e dyanshme dhe mund të shndërrohet në njëra-tjetrën. Audienca, si marrës i përmbajtjes, krijon në të njëjtën kohë përmbajtjen, e cila është komunikim ndërveprues. Integrimi i mediave dixhitale interaktive dhe botës reale i bën njerëzit të hyjnë në një hapësirë komunikimi ku media është e kudogjendur, e gjithëfuqishme dhe e gjithëpranishme.

Në këtë skenar, interneti nuk është vetëm një mënyrë ndërveprimi, por ndikon edhe në ndërveprimin e njerëzve-kompjuter me realitetin.¹⁸ Kur audienca futet në trashëgiminë kulturore virtuale, ajo do të ketë një ndjenjë më të thellë dhe më intuitive të sharmit artistik të trashëgimisë kulturore. Kultura njerëzore dhe aktivitetet e të menduarit çlirohen nga teknologjia dixhitale e informacionit dhe shndërrohen në mënyra të dukshme praktike operacionale. Kultura virtuale e sjelljes lejon një gjendje më fleksibël të ndërveprimit midis vetë subjekteve dhe midis subjekteve dhe objekteve, dhe një përvojë estetike më të pasur dhe më të larmishme të trashëgimisë kulturore.¹⁹

Si përfundim, edhe pse ekzistenca e trashëgimisë kulturore është një domosdoshmëri, si element i identitetit kombëtar, nëse ajo nuk transmetohet siç duhet, vlerat e saj humbasin dhe zhyten në harresën e kohës. Për këtë arsye nevojitet një perceptim i saktë i elementeve materiale dhe jo-materiale të trashëgimisë kulturore, i ndërthurrur nga interpretimi i duhur dhe komunikimi e prezantimi i saj me profesionalizëm, duke shfrytëzuar, jo vetëm burimet dhe njohuritë e trashëgimisë kulturore, por edhe mjetet e transmetimit të saj, si dhe duke vënë në përdorim teknologjinë bashkëkohore virtuale, si një mjet i përhapjes së gjerë të trashëgimisë kulturore dhe si një mënyrë e mbrojtjes së vazhdueshme të vlerave të saj.

BIBLIOGRAFIA

¹⁸ Po aty

¹⁹ Pei J. & Yi L. (2022): Fluid space: Digitalization of cultural heritage and its media dissemination, në "Telematics and Informatics Reports", Volumi 8.

- CHRISTIAN B., THIERRY J. & ISABELLE L. (2006) *Cultural Heritage and Local Development*, Bastianelli, Francë. Merleau-Ponty M., (2012), *Phenomenology of Perception*, Routledge, UK.
- DIMAGGIO, P. (1997), *Culture and Cognition*, në “*Annual Review of Sociology*”, Volumi 23, fq. 263–287. Robert L. Goldstone, Alan Kersten, Paulo F. Carvalho (2018), *Concepts and Categorization*, në “*Handbook of Psychology*”, botimi i dytë.
- ICOMOS (2008), *Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites*, Québec.
- ANDERS HÖGBERG (2016), Rodney Harrison: *Heritage. Critical Approaches*, Routledge, Londër.
- VIVIEN B. (2015), *Social Constructionism*, botimi i tretë, Routledge, Londër.
- Matthias R., Susanne H. (2017): *Communication Model for Built Heritage Assets Going from Knowing to Identification* (2017), World Heritage Coordination, Regensburg, Germany.
- PEI J. & YI L. (2022): *Fluid space: Digitalization of cultural heritage and its media dissemination*, në “*Telematics and Informatics Reports*”, Volumi 8.
- UNWTO (2011), *Communicating Heritage – A Handbook for the Tourism Sector*, World Tourism Organization, Madrid, Spanjë.
- ALBERT B. (2010), *Reality and Technology*, në “*Cambridge Journal of Economics*”, Volumi 34, Faqja 27-35. R. M. Reffat, E. M. Nofal (2013), *Effective communication with cultural heritage using virtual technologies*, në “*International Archives of the Photogrammetry, Remote Sensing and Spatial Information Sciences*”, Volume XL-5/W2.
- BAYT AL-RAZZAZ (2007), *The challenge of adaptive use for a vacant mamluk palace in Cairo*, në “*International Journal of Heritage Studies*”, Volumi 3.